

VENDIM
Nr. 534, datë 8.7.2020

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR NDIHMAT SHTETËRORE TË VITIT 2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, shkronja “dh”, 18, shkronja “e” e 32, pika 2, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit vjetor për ndihmat shtetërore të vitit 2019, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RAPORTI VJETOR
PËR NDIHMAT SHTETËRORE
TË VITIT 2019

I. PËRMBLEDHJE

Raporti vjetor për ndihmat shtetërore është hartuar në zbatim të detyrimeve të sanksionuara në nenin 71, pika 5, të MSA-së, dhe në marrëveshjen e CEFTA-s 2006, për sigurimin e transparencës ndërkombëtare. Raporti është përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë mbështetur në vendimet e Komisionit të Ndhmës Shtetërore për autorizimin e ndihmës shtetërore. Në mënyrën e paraqitjes dhe të analizës së të dhënave në raport është ndjekur metodologjia e Komisionit Evropian.

Të dhënat e përfshira në këtë raport janë raportuar nga zbatuesit e skemave të ndihmës shtetërore: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Bashkia e Tiranës. Pavarësisht se ky raport është për vitin 2018, në të gjenden të dhëna për të gjithë periudhën 2016–2019, duke bërë një krahasim të ndihmës shtetërore, përgjatë këtyre viteve, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në raport me ndihmën shtetërore, të dhënë në vendet e BE-së.

Raporti jep një përshkrim të objektivave kryesorë që janë arritur në fushën e ndihmës shtetërore në Shqipëri, si dhe të instrumentet kryesore të përdorura në periudhën 2015–2019. Shuma e ndihmave shtetërore të dhëna në Shqipëri gjatë viteve 2015–2019 është vlerësuar në rreth 25,562.79 milionë lekë (198.16 milionë €), prej të cilave 8,482.45 milionë lekë (68.97 milionë €), që përfaqësojnë 0.5% të PBB-së, janë dhënë në vitin 2019. Në totalin e ndihmës së dhënë për vitin 2019, vendin kryesor (rreth 50.4%) e zënë ndihmat sektoriale, ndërsa ndihma horizontale përbën 49.6% të ndihmës gjithsej. Megjithatë, pjesa më e madhe e skemave që japin ndihmë shtetërore nuk e tejkalon kufirin *de minimis* të Bashkimit Evropian dhe, si të tilla, përgjithësisht nuk paraqesin problem në këndvështrimin e tregtisë ndërkombëtare.

Instrumentet kryesore të ndihmës shtetërore në Shqipëri gjatë vitit 2019 janë grantet dhe përjashtimi nga taksat, rimbursimi apo reduktimi i shkallës tatimore.

Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, Raporti Vjetor për ndihmat shtetërore për vitin 2018 do t'i përcillet Komisionit Evropian.

II. PËRKUFIZIMI I NDIHMËS SHTETËRORE

- Baza ligjore

Në Shqipëri, ligji i ndihmës shtetërore përcakton rregullat e dhënies së ndihmës shtetërore duke respektuar detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Ligji i ndihmës shtetërore nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, jep përkufizimin e ndihmës shtetërore, kushtet për miratimin e ndihmës shtetërore, kompetencat e strukturave përgjegjëse, procedurën e autorizimit, monitorimin dhe kthimin e ndihmës shtetërore, si edhe detyrimin për hartimin e raportit vjetor për ndihmën shtetërore.

- Përkufizimi i ndihmës shtetërore

Në bazë të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdoq formë e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

Gjithashtu neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹, përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

- Përfitues i ndihmës shtetërore

Përfitues i ndihmës shtetërore është çdo ndërmarrje ose individ që, nëpërmjet akteve dhe masave të ndërmarrja nga shteti, siguron përfitime financiare. Në përcaktimin nëse një masë është ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe të nenit 107 (1) të TFEU-së, strukturat e ndihmës shtetërore vlerësojnë plotësimin e kriterëve të mëposhtme:

- masa duhet të jepet nga shteti dhe të përfshijë burimet shtetërore;
- masa duhet të japë një avantazh ndaj ndërmarrjeve të caktuara ose sektorëve të caktuar; si edhe
- masa ndikon në konkurrencë dhe mund të ndikojnë në tregtinë midis shteteve anëtare.

Çfarë nuk përbën ndihmë shtetërore?

- a) Ndihma për organet publike dhe njësi të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale, të cilat kryejnë një aktivitet joekonomik;
- b) Masa të përgjithshme të destinuara për të gjitha ndërmarrjet dhe të gjithë sektorët e ekonomisë në vend, të tilla si masat tatimore të përgjithshme etj.;
- c) Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve me çmimin e tregut;

2.2 Metodologjia për raportimin e ndihmës shtetërore

Ndihma shtetërore për industrinë dhe shërbimet përfshin kategorinë e ndihmës horizontale dhe ndihmës sektoriale.

Ndihma shtetërore horizontale përfshin:

- ndihmën për kërkim-zhvillim dhe inovacion,
- ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme,
- ndihmën për punësim,
- ndihmën për trajnim,

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.

- ndihmën operacionale,
- ndihmën për sportin,
- ndihmën për kulturën.

Ndihma shtetërore sektoriale përfshin:

- ndihmën për transportin publik,
- ndihmën për shërbimin publik,
- ndihmën për minierat,
- ndihmën për energjinë,
- ndihmën për turizmin.

Ndihma shtetërore jepet duke përdorur disa instrumente si:

A1 – Subvencione dhe grante;

A2 – Përkrahimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulje e shkallës së tatimit ose zbritje e kontributit në sigurimet shoqërore.

III. NDIHMA SHETËRORE NË VITIN 2019

3.1 Vështrim mbi ndihmën shtetërore në periudhën 2014–2019

A. Ndihma shtetërore krahasuar me treguesit kryesore socio-ekonomike

Tabelë nr. 1. Ndihma shtetërore krahasuar me disa me tregues socio-ekonomike 2014–2018

Treguesit	Njësi matjes	2014	Shkallë ndihmë 2014	2015	Shkallë ndihmë 2015	2016	Shkallë ndihmë 2016	2017	Shkallë ndihmë 2017	2018	Shkallë ndihmë 2018	2019	Shkallë ndihmë 2019
PBB	mln lekë	13953	0.23	14843	0.35	14725	0.19	15513	0.24	16309	0.34	16889	0.50
Tëpunësuar (1564-je)	nr	1015924	3.234	1055836	4.750	1120281	2504	1150392	3.302	1174834	4.725	1202337	7.035
Popullsia	nr	2889104	1.126	2880708	1.741	2856101	975	2873457	1.322	2866365	1.937	2852427	2.963
Ndihma shtetërore	mln lekë	325278		504499		280534		379867		555134		848245	


Burimi: MFE

Tabela nr. 1 paraqet të dhënat për ndihmën shtetërore gjithsej në Shqipëri në periudhën 2014–2019, të krahasuara me disa tregues. Ndihma shtetërore gjithsej në vitin 2019 është dhënë në vlerën totale 8,482.45 milionë lekë (68.97 mln euro) e rritur me 52.8 % e krahasuar me vitin 2018.

Shkalla e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së u rrit nga 0.34 % në 2018, në 0.5 % në vitin 2019.

Grafiku nr. 1 paraqet shkallën e ndihmës shtetërore ndaj PBB për periudhën 2014–2019.

Grafik nr. 1. Ecuria e ndihmës shtetërore në raport me PBB 2014 –2019



B. Shkalla e ndihmës shtetërore në Shqipëri dhe shtetet e Bashkimit Evropian

Tabela nr. 2, paraqet informacion për ndihmën shtetërore në Shqipëri dhe 28 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për periudhën 2017–2018.

Tabelë nr. 2. Shkalla e ndihmës shtetërore ndaj PBB për periudhën 2017–2018

Shtetet	Periudha	
	2017	2018
Shqipëria	0.24	0.34
Belgium	0.499	0.788
Bulgaria	1.322	0.992
Czechia	1.414	1.601
Denmark	1.508	1.552
Germany	1.377	1.454
Estonia	0.992	1.022
Ireland	0.176	0.163
Greece	0.275	0.299
Spain	0.257	0.337
France	0.939	0.791
Croatia	1.239	1.541
Italy	0.24	0.306
Cyprus	0.527	0.461
Latvia	1.669	0.997
Lithuania	1.111	1.27
Luxembourg	0.255	0.239
Hungary	2.484	1.829
Malta	1.12	1.217
Netherlands	0.321	0.346
Austria	0.49	0.459
Poland	1.487	1.026
Portugal	0.515	0.449
Romania	0.505	0.545
Slovenia	0.855	0.88
Slovakia	0.296	0.475
Finland	0.828	1.156
Sweden	0.905	0.912
United Kingdom	0.439	0.38

Burimi: Komisioni Evropian, DG Competition² dhe MFE (%)

3.2 Kategoritë e ndihmës shtetërore

Sipas metodologjisë së Bashkimit Evropian, ndihma shtetërore ndahet në dy kategori:

- Ndihmë shtetërore horizontale, dhe
- Ndihmë shtetërore sektoriale.

Ndihma shtetërore horizontale jepet për një numër të madh përfituesish, pa dhënë preferenca për ndonjë aktivitet ekonomik, ndërmarrje ekonomike, produkt apo shërbim, duke minimizuar efektet në konkurrencë.

Ndihma shtetërore sektoriale jepet për aktivitete dhe sektorë të veçantë, duke pasur një ndikim më të madh në konkurrencën në treg.

Tabelë nr. 3. Ndihma shtetërore gjithsej 2015–2019 ndarë sipas kategorive (në milion lekë)

² http://ec.europa.eu/competition/state_aid/scoreboard/index_en.html


KATEGORIA	2015			2016			2017			2018			2019		
	min.lekë	min.euro	në %	min.lekë	min.euro	në %	min.lekë	min.euro	në %	min.lekë	min.euro	në %	min.lekë	min.euro	në %
Ndihma Horizontale	4,108.04	28.84	81.9%	1,813.64	14.16	68.2%	2,379.88	17.86	62.7%	4,082.64	32.00	73.6%	4,210.44	34.23	49.6%
Punësimi	385.34	2.07	5.7%	183.57	1.36	6.9%	196.79	1.48	5.2%	111.78	0.88	2.0%	247.73	2.01	2.9%
Trajnim	136.69	0.99	2.7%	279.23	2.06	10.0%	276.98	2.08	7.3%	150.48	1.18	2.7%	98.22	0.80	1.2%
Sport	2,058.00	14.95	41.0%	167.00	1.23	6.0%	218.80	1.64	5.8%	104.01	0.82	1.9%	121.72	0.99	1.4%
Kultura	41.15	0.30	0.8%	111.27	0.82	4.0%	39.58	0.30	1.0%	134.00	1.05	2.4%	63.32	0.51	0.7%
Ndihma operacionale	38.36	0.28	0.8%	-	-	0.0%	5.02	0.04	0.1%	1,642.90	12.88	29.6%	1,532.90	12.46	18.1%
Kërkim, zhvillim dhe inovacion	1,519.45	11.04	30.3%	1,105.64	8.17	39.4%	1,595.38	11.97	42.0%	1,895.98	14.86	34.2%	2,050.34	16.75	24.3%
SME	29.05	0.21	0.6%	66.93	0.49	2.4%	47.33	0.36	1.2%	43.39	0.34	0.8%	86.71	0.71	1.0%
Ndihma Sektoriale	906.95	6.69	18.1%	891.70	6.89	31.8%	1,418.79	10.86	37.3%	1,488.80	11.61	28.8%	4,272.00	34.73	50.4%
Transport publik (Hekurudha)	440.00	3.20	8.8%	390.00	2.88	13.9%	400.00	3.00	10.5%	400.00	3.14	7.2%	400.00	3.25	4.7%
Shërbimi publik	430.00	3.12	8.6%	428.70	3.17	15.3%	974.90	7.32	25.7%	1,000.00	7.84	18.0%	400.00	3.25	4.7%
Minierat	36.95	0.27	0.7%	39.35	0.29	1.4%	35.00	0.26	0.9%	68.80	0.54	1.2%	25.64	0.21	0.3%
Infrastruktura Broadband	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	491.96	4.00	5.8%
Turizmi	-	-	0.0%	33.65	0.25	1.2%	8.89	0.07	0.2%	-	-	-	2,954.41	24.02	35%
TOTALI	5,014.99	38.43	100	2,805.34	20.74	100	3,798.67	28.61	100	5,551.34	43.61	100	8,482.45	68.97	100

Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

Grafik nr. 2. Ndihma shtetërore gjithsej 2015–2019



Grafik nr. 3. Ndihma shtetërore horizontale/ sektoriale 2015–2019




Të dhënat në tabelën 3 dhe të paraqitura në grafikun 3, tregojnë se në vitin 2019 ndihma shtetërore sektoriale zë pjesën më të madhe të ndihmës shtetërore, gjithsej me 50.4%, ndërsa kategoria e ndihmave horizontale përbën 49.6%.

Në terma nominalë, shpenzimet e përgjithshme të ndihmës shtetërore në vitin 2019 u rritën me rreth 52.8% krahasuar me shpenzimet e vitit 2018 (+2,931.11 milionë lekë). Ky ndryshim i përgjithshëm është si rezultat i faktorëve, si: 1) rritje e ndihmës shtetërore për punësimin prej rreth 135.95 mln lekë; 2) ulje e ndihmës shtetërore për trajnimin prej 52.26 mln lekë; 3) rritje e ndihmës shtetërore për mbështetjen e sportit prej 17.71 mln lekë; 4) ulje e ndihmës shtetërore për kulturën prej 70.68 mln lekë; 5) ulje e ndihmës operacionale prej 110.40 mln lekë; 6) rritje e ndihmës shtetërore për kërkimin dhe zhvillimin prej 164.26 mln lekë; 7) rritje e ndihmës shtetërore për SME-të prej 43.32 mln lekë; 8) ulje e ndihmës shtetërore për shërbimin publik (ujësjellësit) prej 600 mln lekë; 10) ulje e ndihmës shtetërore për minierat prej 43.16 mln lekë; rritje/dhënie e ndihmës për infrastrukturën *broadband* prej 491.96 mln lekë; dhe rritje/dhënie e ndihmës shtetërore për sektorin e turizmit prej 2,954.41 mln lekë.

Grafiku nr. 4, paraqet ndryshimin gjithsej të shpenzimeve të ndihmës shtetërore sipas objektivave ndërmjet 2019 dhe 2018 në Shqipëri (në milionë lekë).

Grafik nr. 4. Ndryshimi i ndihmës shtetërore



Burimi: MFE

3.2.1 Ndhma shtetërore horizontale


Në vitin 2019 ndihma shtetërore horizontale në vlerë absolute është 4,210.44 mln lekë (34.23 mln euro). Peshën kryesore për këtë kategori të ndihmës e ka ndihma për kërkim, zhvillim dhe inovacion me 49 %.

Tabelë nr. 4. Ndhma shtetërore horizontale 2014–2019


Ndihma Horizontale	2014		2015		2016		2017		2018		2019	
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR
Punësimi	150.08	1.07	285.34	2.07	183.57	1.36	196.79	1.48	112.10	0.88	247.73	2.01
Trajnim	109.84	0.78	136.69	0.99	279.23	2.06	276.98	2.08	150.48	1.18	98.22	0.80
Sport	644.00	4.60	2,058.00	14.95	167.00	1.23	218.80	1.64	104.01	0.82	121.72	0.99
Kultura	-	-	41.15	0.30	111.27	0.82	39.58	0.30	134.00	1.05	63.32	0.51
Ndihma operationale	836.33	5.97	38.36	0.28	-	-	5.02	0.04	1,642.90	12.88	1,532.50	12.46
Kërkim, zhvillim dhe inovacion	1,378.72	25.7	1,519.47	11.04	1,105.64	8.17	1,595.38	11.97	1,885.98	14.86	2,060.24	16.75
SME	37.46	0.27	29.05	0.21	66.93	0.49	47.33	0.36	43.39	0.34	86.71	0.71
TOTALI	3,156.43	15.26	4,108.06	29.84	1,913.63	14.15	2,379.88	17.86	4,082.86	32.00	4,210.44	34.23

Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

Grafik nr. 5. Ecuria e ndihmës shtetërore horizontale 2015–2019



Grafik nr. 6. Struktura e ndihmës shtetërore horizontale për vitin 2019



Ndhma horizontale në vitin 2019 është në vlerën 4,210.44 mln lekë. Në mënyrë më të

detajuar të dhënat për ndihmën shtetërore jepen më poshtë:

Ndihma për punësim: ndihma për punësim jepet nëpërmjet 7 skemave të ndihmës shtetërore. Skemat janë të miratuara me vendime të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, si më poshtë:

1. Vendimin e KNSH-së nr. 11, datë 15.3.2007 “Për skemën ekzistuese ‘Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë’”;
2. Vendimin e KNSH-së nr. 13, datë 15.3.2007 “Për skemën ekzistuese ‘Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit institucional’”;
3. Vendimin e KNSH-së nr. 38, datë 19.9.2011 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore ‘Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta’”;
4. Vendimin e KNSH-së nr. 39, datë 19.9.2011 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore ‘Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë që hyjnë për herë të parë në punë’”;
5. Vendimin e KNSH-së nr. 40, datë 19.9.2011 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore ‘Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit për ofrimin e shërbimit të formimit profesional të punëkërkuesve të papunë nga persona juridikë/fizikë privatë dhe organizata jofitimprurëse’”;
6. Vendimin e KNSH-së nr. 47, datë 28.3.2014 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore ‘Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar’”;
7. Vendimin e KNSH-së nr. nr. 62, datë 14.12.2015 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore ‘Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit’”.

Nga skema e ndihmës shtetërore me qëllim nxitjen e punësimit kanë përfituar gjithsej 513 ndërmarrje, duke punësuar gjithsej 4195 punëkërkues të papunë.

Ndihma për trajnim: skema e ndihmës shtetërore e miratuar me vendimin e KNSH-së nr. 12, datë 15.3.2007 “Për skemën ekzistuese ‘Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë’”, ka si qëllim trajnimin e punëkërkuesve, të cilët më pas sigurojnë vendin e tyre të punës në ndërmarrje të cilat janë përfituese të ndihmës shtetërore. Në vitin 2019 kanë përfituar gjithsej 87 ndërmarrje, duke u trajnuar 1143 punëkërkues të papunë. Për këtë skemë të ndihmës shtetërore janë shpenzuar fonde nga buxheti i shtetit gjithsej në shumën 98.225.273 lekë.

Ndihma për sportin: komisioni me vendimin nr. 54, datë 26.1.2015 “Për skemën ekzistuese të mbështetjes me grante nga buxheti i shtetit në sektorin e sportit”. Për këtë skemë ndihme, objektivi kryesor i së cilës është nxitja e kulturës së sportit, edukimit të sportit dhe aktiviteteve fizike duke rritur pjesëmarrjen e shtetasve në sport, për vitin 2019 janë shpenzuar nga buxheti i shtetit 121.72 milionë lekë.

Përfituesit e skemës janë 21 federata të ndryshme sportive që ofrojnë shërbime sportive për anëtarët e tyre. Federatat shqiptare të sportit janë organizata jofitimprurëse, të cilat kanë për qëllim të zhvillojnë, promovojnë, kontrollojnë, dhe të rregullojnë aktivitetet sportive të shoqatave dhe klubeve, të cilat janë anëtarë të federatave të tyre, në përputhje me statutet e tyre. Mbështetja me grante nga buxheti i shtetit jepet për financimin për mbulimin e kostove të personelit dhe investimeve.

Ndihma për nxitjen e kulturës: në vitin 2019 ndihma shtetërore për nxitjen e kulturës është dhënë në vlerën 63.32 milionë lekë. Ndihma shtetërore është dhënë në formën e mbështetjes financiare me fonde publike për projektet me thirrje dhe në zbatim të prioritetëve institucionale në programin e fushës së art-kulturë për 144 projekte dhe aktivitete artistike-kulturore me fokus:

- platforma dhe programe të edukimit përmes artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore;
- platforma dhe projekte në funksion të turizmit kulturor;
- platforma dhe projekte që punësojnë dhe angazhojnë numër të lartë të artistëve apo subjekteve që lidhen me kulturën;
- projekte kulturore inovative-digjitale
- projekte të industrive kreative.

Ndihma operationale: Kjo kategori përfshin skemën e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse të konsumuar në serat me ngrohje dhe industrinë. Për vitin 2019 raportohet se është dhënë ndihmë shtetërore në shumën 1,532.5 milionë lekë, nëpërmjet skemës së rimbursimit të akcizës

së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agro-industriale.

Ndihma për kërkim dhe zhvillim. Ndihma shtetërore për kërkim dhe zhvillim është dhënë për ndërmarrjet që nënshkruajnë “marrëveshje hidrokarburesh” dhe nënkontraktuesit e tyre, duke iu ofruar një përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar të të gjithë kontraktorëve dhe nënkontraktorëve për realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure. Në vitin 2019, është raportuar se kompanitë e huaja që kryejnë operacione hidrokarbure në Shqipëri kanë përfituar përjashtime në import (TVSH dhe përjashtime doganore), në shumën 2,060.24 milionë lekë (në vitin 2018 shuma e përjashtimeve ishte 1,895.98 milionë lekë).

Ndihma për SME: Në vitin 2019 nga skema e ndihmës shtetërore për SME-të kanë përfituar gjithsej 170 ndërmarrje të vogla dhe të mesme, prej të cilave 94 ndërmarrje të mbështetura nga fondet e AIDA-s dhe 76 ndërmarrje nga skema e ndihmës shtetërore të dhënë nga Bashkia e Tiranës.

AIDA

Vlera e ndihmës gjithsej për SME-të është 66.91 milionë lekë e ndarë në:

- Fondi i Ekonomisë kreative në vlerën 9.978.321 lekë;
- Fondi i Konkurrueshmërisë në vlerën 32.976.822 lekë;
- Fondi *Start-up* në vlerën 9.151.378 lekë;
- Fondi i Inovacionit në vlerën 14.810.000 milionë lekë.

Bashkia e Tiranës vlera e ndihmës gjithsej për SME-të është 19.8 milionë lekë, e ndarë në:

- Plani i ndihmës shtetërore për fuqizimin e grave dhe nxitjen e sipërmarrjes në vlerën 10 milionë lekë;
- Plani i ndihmës shtetërore për nxitjen e punësimit të biznesit rinor në vlerën 8 milionë lekë;
- Plani i ndihmës shtetërore për të rinj dhe të reja drejt një profesioni në vlerën 1.806.995 lekë.

3.2.2 Ndihma shtetërore sektoriale


Në vitin 2019 ndihma shtetërore sektoriale në vlerë absolute është 4, 272.8 mln lekë (34.72 mln euro). Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2019 është 40.8 %.

Tabelë nr. 5. Ndihma shtetërore sektoriale 2014–2019


Ndihma sektoriale	2014		2015		2016		2017		2018		2019	
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR
Transport publik	440.00	3.14	440.00	3.20	390.00	2.88	400.00	3.00	400.00	3.14	400.00	3.25
Shërbimi publik	450.00	3.21	430.00	3.12	428.70	3.17	974.90	7.32	1,000.00	7.84	400.00	3.25
Minierat	29.00	0.21	36.95	0.27	39.35	0.29	35.00	0.26	68.80	0.54	25.64	0.21
Infrastruktura	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	481.96	4.00
Turizmi	-	-	-	-	33.65	0.25	8.89	0.07	-	-	2,954.41	24.02
TOTALI	919.00	9.56	906.95	6.59	891.70	6.59	1,418.79	10.65	1,468.80	11.51	4,272.00	34.73

Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

Grafik nr. 7. Ecuria e ndihmës shtetërore sektoriale 2014–2019



Grafik nr. 8. Struktura e ndihmës shtetërore sektoriale 2019



Në strukturën e ndihmës sektoriale (vertikale) për vitin 2019, peshën kryesore e zë ndihma për shërbimet publike (ndihma për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve), duke vijuar me ndihmën për transportin publik (hekurudha) dhe ndihmën për minierat (në mbyllje dhe konservim).

Ndihma për transportin publik, e dhënë nga buxheti i shtetit për mbështetjen e transportit hekurudhor, është 400 milionë lekë edhe në vitin 2019.

Ndihma për shërbimet publike: në vitin 2019 ndihma për shërbimet publike është në formën e subvencionit nga buxheti i shtetit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve në shumën 400 milionë lekë.

Ndihma për minierat: ndihma për minierat nga buxheti i shtetit për vitin 2019 jepet për vazhdimin e mbylljes së minierave të shfrytëzuara dhe joefektive, privatizimi i aseteve për të mundësuar monitorimin e fenomeneve të post shfrytëzimit në shumën 25.64 milionë lekë.

Ndihma për infrastruktura/Broadband: në bazë të vendimit të Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 89, datë 23.4.2019 “Autorizimi i ndihmës shtetërore për dixhital-divident”, Autoriteti i Mediave Audiovizive në cilësinë e dhënësit të ndihmës shtetërore ka dhënë ndihmën në vlerën 4 milionë euro (491.96 mln lekë). Përfitues të skemës janë operatorët historikë kombëtarë, si edhe operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike.

Ndihma për turizmin: ndihma për sektorin e turizmit nga buxheti i shtetit për vitin 2019 është përfutur nga strukturat akomoduese nga reduktimi i TVSH-se nga 20% në 6% për vitin 2019, më përfutues gjithsej 2,527 subjekte në shumën 2,954,407,314 lekë.

Subjektet që kanë përfutur statusin e veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 5 vje, status special”, dhe kanë nënshkruar Marrëveshje Zhvillimi me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për vitin 2019, janë si më poshtë:

1. “Tirana Business Park” sh.p.k.

- VKM nr. 153, datë 20.3.2019 “Për dhënien e statusit të veçantë ‘Investitor në strukturë akomoduese me 5 vje, status special’, aplikuesit ‘Tirana Business Park’ sh.p.k.”.

- Nënshkruar marrëveshje zhvillimi me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, datë 30.4.2019.

2. “Concord Investment” sh.p.k.

- VKM-ja nr. 300, datë 10.5.2019 “Për dhënien e statusit të veçantë ‘Investitor në strukturë Akomoduese me 5 vje, status special’, aplikuesit ‘Concord investment’ sh.p.k.”.

- Nënshkruar marrëveshje zhvillimi me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, datë 12.6.2019.

IV. INSTRUMENTET E SHPËRNDARJES SË NDIHMËS SHTETËRORE

Ndihma shtetërore e dhënë nga burime shtetërore, në varësi të llojit (instrumentit) të përdorur, përbën një shpenzim real apo potencial të pasurisë publike duke pasur një efekt në mbledhjen e të ardhurave publike. Në vitin 2019, ndihma shtetërore është dhënë kryesisht në formën e subvencioneve dhe incentivave fiskale. Referuar metodologjisë së përdorur nga BE-ja, instrumentet e ndihmës shtetërore klasifikohen në:

A1 – subvencione dhe grante;

A2 – përjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet

sociale;

B – pjesëmarrja në kapital;

C1 – bua të buta;

C2 – instrumente të tjera;

D – garancitë.

Tabelë nr. 6. Ndihma shtetërore gjithsej sipas instrumenteve

Kategoria e ndihmës	Subvencione dhe Grante (A1)	Përfshirje nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale (A2)
Ndihma Horizontale		
Punësimi	247.73	
Trajnim	98.22	
Sport	121.72	
Kultura	63.32	
Ndihma operacionale		1,532.50
Kërkim, zhvillim dhe inovacion		2,060.24
SME	86.71	
Ndihma Sektoriale		
Transport publik (Hekurudha)	400.00	
Shërbimi publik	400.00	
Minierat	25.64	
Infrastruktura Broadband	491.96	
Turizmi		2,954.41
TOTALI	1,935.30	6,547.15

Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

Instrumenti i përdorur më shumë është A2 – përfshirja nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale, sikurse paraqitet edhe në grafikun nr. 8.

Grafik nr. 9. Struktura e shpërndarjes të instrumenteve të ndihmës shtetërore për vitin 2019

